



Dokumenti i dytë:  
Nëntor 2019

# PLANI I PERFORMANCËS AFATMESËM BUXHETORE 2020 - 2022

## BASHKIA BELSH

*Ky raport është përgatitur nga Bashkia Belsh me asistencën e Projektit "Bashki të Forta" dhe Shapo Consulting.*

*Për më shumë informacion kontaktoni Z. Alban Nipolli në adresën:  
[alban\\_nipolli@hotmail.com](mailto:alban_nipolli@hotmail.com)*


## BURIMET E FINANÇIMIT

Në Mijë Lekë	2017	2018	2019	2020	2021	2022
<b>Burimet e Veta</b>	<b>45,556</b>	<b>37,890</b>	<b>91,063</b>	<b>102,069</b>	<b>103,591</b>	<b>104,610</b>
Taksat Lokale	34,497	19,161	67,659	74,438	74,438	74,438
Taksat e ndara	4,782	5,692	5,540	6,322	7,339	7,986
Tarifat vendore	5,020	9,675	12,896	16,258	16,613	16,986
Të ardhura të tjera	1,257	3,362	4,968	5,050	5,200	5,200
<b>Të ardhura nga buxheti qendror</b>	<b>290,583</b>	<b>234,007</b>	<b>173,809</b>	<b>179,366</b>	<b>189,358</b>	<b>197,804</b>
Transferta pakushtëzuar	110,928	114,003	116,448	123,866	133,658	141,904
Transferta kushtëzuar	140,706	64,966	-	-	-	-
Për funksionet e deleguara	-	-	-	-	-	-
Projekte të veçanta(FZHR dhe të tjera)	140,706	64,966	-	-	-	-
Transferta specifike	38,950	55,038	57,361	55,500	55,700	55,900
<b>Trashëgimi nga vitit i kaluar</b>	<b>164,209</b>	<b>70,538</b>	<b>88,712</b>	-	-	-
<b>TOTAL BURIME FINANCIARE</b>	<b>500,347</b>	<b>342,434</b>	<b>353,584</b>	<b>281,435</b>	<b>292,949</b>	<b>302,414</b>

Bashkia siguron rreth 51% të të ardhurave buxhetore prej burimeve të veta: taksa; tarifa; dhe të ardhura të tjera prej menaxhimit të aseteve apo donacioneve plus shpenzime të trashëguara nga viti kaluar dhe rreth 49% prej transfertave të qeverisë qofshin ato të pakushtëzuara apo kushtëzuara. 2% e të ardhurave të bashkisë sigurohen nga huamarrja.


Bashkia parashikon një rritje të të ardhurave nga burimet e veta prej 12.1% në 2020, 1.5% në 2021 dhe 1.0% gjatë vitit 2022. Transfertat qeveritare parashikohen të rriten me 3.2% në vitin 2020, 5.6% në vitin 2021 dhe 4.5% gjatë vitit 2022.

### Parashikim i transfertave qeveritare




Kontributi i Qeverisë Qëndrore

### Parashikim i të ardhurave nga burimet e veta



Të Ardhura Buxhetore prej Burimeve të veta

## SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE




Bashkia Belsh mbështet financiarisht të gjitha shërbimet publike ligjore që i mandaton ligji duke filluar nga shërbimet e përgjithshme publike si: menaxhimi i hapësirave publike; mirëmbajtja e varrezave; ndriçimi i hapësirave publike; mirëmbajtja dhe investime në infrastrukturën rrugore dhe atë të lagjeve; shërbimet e çerdheve dhe kopshteve; planifikimin urban; zhvillimin e ekonomisë vendore dhe turizmit; shërbimet sociale për shtresat në nevojë; sigurimin e infrastrukturës së institucioneve arsimore parashkollore dhe bazë; parauniversitare; qendrat e shëndetit parësor; aktivitetet kulturore artistike; menaxhimin e mbetjeve bashkiake; ofrimin e ujit të pijshëm dhe menaxhimin e kanalizimeve sanitare dhe trajtimin e ujërave të ndotura; mbrotjen e mjedisit; pyjeve kullotave; emergjencat civile; menaxhimin e sistemit të kanaleve kulluese dhe vaditëse etj.

### Programe në fokus të bashkisë



## SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK



Një rënie prej 49% e investimeve është parashikuar për vitin 2020 dhe përkatësisht një rritje vjetore prej 12% dhe 9% në vit përkatësisht në dy vitet e ardhshme. Lista e investimeve të parashikuara mundohet të jetësojë planin e përgjithshëm vendore të bashkisë, ndërkohë që programet më të mbështetura me investime janë:

### Investime të parashikuara 2020 - 2022



### Programet më të mbështetura me investime



Rrjeti rrugor rural **66.5%**




Shërbime publike vendore **18%**



Planifikimi, menaxhimi, administrimi **8.5%**

## INVESTIMET 2020 – 2022 (Pesha e investimeve sipas programeve 2019)




Vlera totale e kontratave të investimeve të parashikuara për tre vite është rreth **30,6 milionë lekë.**


**30,6**  
Milionë  
lekë

# TREGUESIT FINANCIAR


Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave





Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave



Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave





# Performanca e programeve buxhetore të bashkisë

## Parashikimi afatmesëm

Bashkia ofron 36 shërbime publike, nga të cilat ka buxhetuar për të financuar nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse 10 prej tyre të ndara në 6 fukione të saj ligjore:

### **1 – ORGANET EKZEKUTIVE DHE LEGJISLATIVE, ÇËSHTJE FINANCIARE E FISKALE, DHE ÇËSHTJET E BRENDSHME**

#### **1.1 Planifikim, menaxhim dhe administrim**

### **2 - RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE**

#### **2.1 Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile**

### **3 – ÇËSHTJE EKONOMIKE**

#### **3.1 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit**

#### **3.2 Administrimi i pyjeve dhe kullotave**

#### **3.3 Rrjeti rrugor rural + urban**

### **4 – STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT**

#### **4.1 Shërbimet publike vendore**

#### **4.2 Programet e zhvillimit**

### **5 – ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA**

#### **5.1 Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore**

### **6 – ARSIMI**

#### **6.1 Arsimi parashkollor përfshirë arsimin bazë**

#### **6.2 Arsimi i mesëm i përgjithshëm**

Rezultatet e synuara të treguesve të performancës gjatë tre viteve të ardhshme 2020-2022 tregojnë:



**Përmirësim**



**E njëjta situatë**




**Përkeqësim**




**Nuk ka informacion**



# ORGANET EKZEKUTIVE DHE LEGJISLATIVE, ÇËSHTJE FINANCIARE E FISKALE, DHE ÇËSHTJET E BRENDSHME





## PLANIFIKIMI, MENAXHIMI, ADMINISTRIMI

Shpenzime	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan2022
Shpenzime Korente	72,861	74,580	82,373	95,321	95,674	95,850
Shpenzime Kapitale	50	1,167	6,071	7,000	7,000	7,000
<b>Total Shpenzime</b>	<b>72,911</b>	<b>75,747</b>	<b>88,443</b>	<b>102,321</b>	<b>102,674</b>	<b>102,850</b>

Zë rreth 25% të buxhetit të bashkisë. Gjatë tre viteve të ardhshme bashkia synon ta përmirësojë punën e saj.

Qëllimi i programit buxhetor	Objektivi 2020-2022
Qeverisja vendore është përgjegjëse dhe administrata e saj transparente	Përmirësimi i stafit të bashkisë


Suksesin e përdorimit të parave publike në këtë program bashkia e mat me anë të treguesve të performancës të cilët synojnë përmirësim në tre vitet e ardhshme.

### Treguesit e Performancës Buxhetore

Matja e Treguesve të Performancës Buxhetoreking	Fakt	Synimet				
	2018	2019	2020	2021	2022	
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	5%	3%	2%	2%	2%	
Raporti i numrit totali të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajuar (ditë trajnimi për person në vit)	3.3	4.0	3.2	3.2	3.2	
Sipërfaqe administrative ndaj numrit total të punonjësve në godinën e bashkisë në qendër (m2 për punonjës)	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	

## Treguesit e Performancës Buxhetore


Bashkia ka gjithsej 223 punonjës me kohë të plotë pune, nga të cilët punonjës të administratës së bashkisë janë 66.



Ky program buxhetor mbështet aktivitetin e përditshëm të personelit të administratës së bashkisë si

- Shërbimet e prokurimit
- Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore
- Mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parce qendrore automjete, zyra të printimit dhe IT etj.
- Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit.
- Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e bashkisë, këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit

## Performanca e Administratës së Bashkisë 2018 - 2022



### Tregues Performance

### Trendi në parashikim

TP 1. Rritja e qëndrueshmërisë së administratës civile




TP 2. Rritja e kapaciteteve / burimeve njerëzore të bashkisë




TP 3. Përmirësimi i punës së stafit të bashkisë



# RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE



6.1%



## SHËRBIMET E MBROJTJES NGA ZJARRI

Shpenzime	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan2022
Shpenzime Korente	-	5,394	20,635	10,285	10,222	10,176
Shpenzime Kapitale	-	3,828	1,060	-	-	-
<b>Total Shpenzime</b>	-	<b>9,222</b>	<b>21,695</b>	<b>10,285</b>	<b>10,222</b>	<b>10,176</b>

Zë rreth 6.1% të buxhetit të bashkisë. Gjatë tre viteve të ardhshme bashkia synon ta përmirësojë punën e saj.

Qëllimi i programit buxhetor	Objektivi 2020-2022
<b>Përmirësimi i sigurisë së jetës dhe pronës së komunitetit</b>	Përmirësimi i shërbimeve dhe infrastrukturës së shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit

Suksesin e përdorimit të parave publike në këtë program bashkia e mat me anë të treguesve të performancës të cilët synojnë përmirësim në tre vitet e ardhshme.

## Treguesit e Performancës Buxhetore

Matja e Treguesve të Performancës Buxhetore	Fakt	Synimet			
		2018	2019	2020	2021
<b>Stacion MZSH</b>	1	1	0	0	0
<b>Ndryshimi në sekonda i daljes nga stacioni:</b>	Ni	0	0	0	0
<b>Total shpenzime për SHMZ kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara</b>	922,164	2,086,846	Ni	Ni	Ni
<b>Numri i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit (rritja vjetore në %)</b>	Ni	-20%	Ni	Ni	Ni
<b>Numri i vizitave/inspektimeve tek të tretët (rritja vjetore në %)</b>	Ni	150%	Ni	Ni	Ni


Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Mbrojtjes Civile e cila menaxhon këtë program ka 14 punonjës me kohë të plotë pune, numër i cili parashikohet të mbetet i pandryshuar në tre vitet e ardhshme.

Ky program buxhetor mbështet aktivitetin e përditshëm të personelit të administratës së bashkisë si:


- **Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;**
- **Mbrojtja civile dhe administrim i strukturave përkatëse;**
- **Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;**
- **Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, evakuimi i zonave të përmytura etj.**
- **Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundërzjarrit;**

Përgjatë tre viteve bashkia nuk parashikon investime për emergjencat civile.

### Performanca e Zjarrfikëve




### Koha e daljes nga stacioni, në sekonda



---


**Tregues Performance****Trendi në parashikim**

---


<b>TP 1.</b>	Reagim më i shpejtë ndaj njoftimeve për zjarre	=
<b>TP 2.</b>	Rritja e ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimi	
<b>TP 3.</b>	Përmirësimi I të ardhurave nga tariva e shërbimit të MZSH	?
<b>TP 4.</b>	Rritja e efijencës buxhetore në ofrimin e shërbimit SHMZ	?

---

# ÇËSH TJET EKONOMIKE







## MENAXHIMI I INFRASTRUKTUËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Shpenzime	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan2022
Shpenzime Korente	8,882	9,075	9,589	9,495	9,510	9,525
Shpenzime Kapitale	9,055	12,113	15,889	6,000	6,000	6,000
<b>Total Shpenzime</b>	<b>17,937</b>	<b>21,188</b>	<b>25,478</b>	<b>15,495</b>	<b>15,510</b>	<b>15,525</b>

Zë rreth 7.2% të buxhetit të bashkisë. Gjatë tre viteve të ardhshme bashkia synon ta përmirësojë punën e saj.

Qëllimi i programit buxhetor	Objektivi 2020-2022
Rritja e prodhimeve bujqësore dhe mbrotjes nga përmbytjet	Përmirësimi i infrastrukturës së sistemit të vaditjes dhe kullimit

Suksesin e përdorimit të parave publike në këtë program bashkia e mat me anë të treguesve të performancës të cilët synojnë përmirësim në tre vitet e ardhshme.

### Treguesit e Performancës Buxhetore

Matja e Treguesve të Performancës Buxhetore	Fakt	Synimet			
	2018	2019	2020	2021	2022
Sipërfaqe e mbuluar me ujitje (ndryshimi vjetor në %)	Ni	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Sipërfaqe e mbuluar me kullim (ndryshimi vjetor në %)	Ni	0%	0%	0%	0%
Nr. Familjeve përfituese të shërbimit ujitje dhe kullim (ndryshimi vjetor në %)	Ni	3.2%	3.1%	3.0%	1.4%
Familje rurale përfituese ( në % ndaj totalit të familjeve rurale)	34%	36%	37%	38%	38%
Km kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (në %)	42%	66%	71%	77%	82%
Km kanal ujitës/vadites të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (në %)	2%	3%	4%	4%	4%
Sipërfaqja e tokës bujqësore të inventarizuar (në % ndaj totalit të tokës bujqësore)	89.8%	89.8%	89.8%	89.8%	89.8%
Sip. Toke e kultivuar në % kundrejt totalit të inventarit të tokës bujqësore	51%	51%	53%	53%	54%


Struktura e cila menaxhon këtë program buxhetor ka 2 punonjës me kohë të plotë pune, si pjesë e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, numër i cili parashikohet të mbetet i pandryshuar në tre vitet e ardhshme.

Ky program buxhetor mbështet aktivitetin e përditshëm të personelit të administratës së bashkisë si:

- **Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, hua dhe financime për punime të tilla;**
- **Administrim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën përgjegjësinë e njëjësive të vetëqeverisjes vendore**

Përgjatë tre viteve bashkia parashikon investime në infrastrukturën e sistemit vaditës dhe kullues në një vlerë mbi 18 milionë Lekë..

### Performanca e ujitjes dhe kullimit




■ Sipërfaqe e tokës së kultivuar në ha

■ Numri i familjeve përfituese nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit

■ Nga Keta: ujitjen (ha)

■ Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje (në ha)


## Treguesit e performacës UJITJA DHE KULLIMI



### Tregues Performance

### Trendi në parashikim

<b>TP 1.</b>	Rritja e ekonomisë bujqësore	↗
<b>TP 2.</b>	Përmirësimi i sistemit kullues	↗
<b>TP 3.</b>	Rritja e ekonomisë bujqësore (përfituesve)	↗
<b>TP 4.</b>	Rritja e efijencës buxhetore në menaxhimin e kanaleve ujitëse dhe kulluese	↗



0.3%

## ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Shpenzime	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan2022
Shpenzime Korente	613	633	881	715	716	737
Shpenzime Kapitale	-	-	-	-	-	-
<b>Total Shpenzime</b>	<b>613</b>	<b>633</b>	<b>881</b>	<b>715</b>	<b>716</b>	<b>737</b>

Zë rreth **0,3%** të buxhetit të bashkisë. Gjatë tre viteve të ardhshme bashkia synon ta përmirësojë punën e saj.

Qëllimi i programit buxhetor	Objektivi 2020-2022
Bashkia siguron përdorim të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave	Rritja e produkteve nga pyjet dhe kullotat

Suksesin e përdorimit të parave publike në këtë program bashkia e mat me anë të treguesve të performancës të cilët synojnë përmirësim në tre vitet e ardhshme.

### Treguesit e Performancës Buxhetore

Matja e Treguesve të Performancës Buxhetore	Fakt	Synimet			
	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i pemëve të shtuara/zëvendësuara çdo vit sipas nevojave) Ndryshimi vjetor në %	Ni	-25%	150%	0%	0%
Nr. kontrollesh dhe inspektimesh kundrejt Sip. Totale të pyjeve dhe kullotave (inpektime për ha)	0.013	0.018	0.018	0.018	0.018
Numri i punonjësve kundrejt fondit pyjor dhe kullor (punonjës për 1000 ha pyje dhe kullota) pritët	2.24	2.24	2.24	2.24	2.24
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullor (ndryshimi vjetor në %)	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%


Struktura e cila menaxhon këtë program buxhetor ka 1 punonjës me kohë të plotë pune, si pjesë e Drejtorisë së Pyjeve, numër i cili parashikohet të mbetet i pandryshuar në tre vitet e ardhshme.

Ky program buxhetor mbështet aktivitetin e përditshëm të personelit të administratës së bashkisë:


- Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore;
- Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore;
- Administrim i fondit pyjor dhe kullosor publik;
- Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e liçencave për prerje pemësh;
- Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë përhirë menaxhimin e kullotjes;
- Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore;
- Organizim ose mbështetje për veprimtarinë rryllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimi i shërbimeve për operatorët pyjorë;
- Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore;

Përgjatë tre viteve bashkia nuk parashikon investime.

### Pyjet dhe kullotat



	Tregues Performance	Trendi në parashikim
TP 1.	Planet e menaxhimit të fondit pyjor dhe kullosor	=
TP 2.	Rritja e inspektimit të fondit pyjor dhe kullosor	↗
TP 3.	Rinovimi i fondit pyjor dhe kullosor	=
TP 4.	Shtimi i fondit pyjor dhe kullosor	=
TP 5.	Efiçienca e përdorimit të buxhetit të alokuar për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	=



35%

## RRJETI RRUGOR RURAL

Shpenzime	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan2022
Shpenzime Korente	7,474	-	7,828	7,850	7,930	8,070
Shpenzime Kapitale	203,967	-	116,427	49,000	55,243	61,000
<b>Total Shpenzime</b>	<b>211,441</b>	<b>11,816</b>	<b>124,255</b>	<b>56,850</b>	<b>63,173</b>	<b>69,070</b>

Zë rreth **35%** të buxhetit të bashkisë. Gjatë tre viteve të ardhshme bashkia synon ta përmirësojë punën e saj.

Qëllimi i programit buxhetor	Objektivi 2020-2022
<b>Përmirësimi i komunikimit ndërlokal</b>	Bashkia siguron akses rrugor të të gjitha njësive administrative të saj tek shërbimet bazike (qendra shëndetësore; shkolla publike etj.)

Suksesi e përdorimit të parave publike në këtë program bashkia e mat me anë të treguesve të performancës të cilët synojnë përmirësim në tre vitet e ardhshme.

### Treguesit e Performancës Buxhetore


Struktura e cila menaxhon këtë program buxhetor ka 15 punonjës me kohë të plotë pune, si pjesë e Drejtorisë së Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës, numër i cili parashikohet të mbetet i pandryshuar në tre vitet e ardhshme.

Ky program buxhetor mbështet aktivitetin e përditshëm të personelit të administratës së bashkisë si:

- **Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësi e njësive së vetëqeverisjes vendore;**
- **Kontraktimi i shoqërive private të transportit për sigurimin e shërbimeve të transportit publik lokal;**
- **Mbikëqyrje dhe rregullim i shërbimeve të transportit publik lokal të shoqërive private (miratimi i tarifave për pasagjerët dhe i orëve dhe shpeshtësisë së shërbimeve etj.);**
- **Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimin e njësive vendore;**
- **Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, orareve etj.. të operacioneve të sistemit publik lokal të transportit;**
- **Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësive vendore**
- **Grante, hua ose financime për të mbështetur funksionimin, ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve dhe strukturave të transportit publik lokal.**

Përgjatë tre viteve bashkia parashikon investime të konsiderueshme në vlerën mbi 165 milionë Lekë. Fondi i investimeve në rrjetin rrugor përgjatë tre viteve përbën rreth 67% të portofolit të investimeve të programit tre vjeçar të bashkisë.

### Rrjeti rrugor 2015 - 2022



#### Tregues Performance


#### Trendi në parashikim

- TP 1. Zgjerimi i rrjetit rrugor
- TP 2. Përmirësim i efikasitetit në përdorimin e buxhetit për menaxhimin e rrjetit rrugor




**Ni**


# STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT







## SHËRBIMET PUBLIKE VENDORE PROJEKTE ZHVILLIMI



Shpenzime	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan2022
Shpenzime Korente	36,563	38,254	46,000	46,576	47,941	48,905
Shpenzime Kapitale	9,750	1,899	1,460	12,179	15,000	17,000
<b>Total Shpenzime</b>	<b>46,313</b>	<b>40,153</b>	<b>47,460</b>	<b>58,755</b>	<b>62,941</b>	<b>65,905</b>

Zë rreth **13.4%** të buxhetit të bashkisë. Gjatë tre viteve të ardhshme bashkia synon ta përmirësojë punën e saj.

Qëllimi i programit buxhetor	Objektivi 2020-2022
<b>Përmirësimi i cilësisë së jetës së komunitetit</b>	Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të gjelbërimit, dekorit dhe të funeraleve

Suksesin e përdorimit të parave publike në këtë program bashkia e mat me anë të treguesve të performancës të cilët synojnë përmirësim në tre vitet e ardhshme.

### Treguesit e Performancës Buxhetore


Matja e Treguesve të Performancës Buxhetore	Fakt	Synimet			
	2018	2019	2020	2021	2022
Sipërfaqe e gjelbëruar për banor të z.urbane (m katror/banor)	0.66	0.99	0.99	0.99	0.99
Sipërfaqe e gjelbëruar që mirëmbahet (ndryshimi vjetor në %)	Ni	50.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Rrënjë pemë të reja të mbjella kundrejt vitit të kaluar (ndryshimi në %)	Ni	75%	-5%	25%	4%
Total km linear trotuar kundrejt vitit të kaluar (ndryshimi në %)		3%	13%	18%	0%

Përgjatë tre viteve të ardhshme bashkia planifikon investime në vlerën totale 44 milionë Lekë (ose rreth 18% të portofolit të investimeve në tre vite). Ky program menaxhohet nga 65 punonjës me kohë të plotë pune si pjesë e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të bashkisë, numër i cili parashikohet të mbetet i njëjtë përgjatë tre viteve të ardhshme.

Ky program buxhetor mbështet aktivitetin e përditshëm të personelit të administratës së bashkisë si:

- **Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin.**
- **Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapësirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve.**
- **Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapësirën e gjelbërt të njësive të vetëqeverisjes vendore.**
- **Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.**


### Shërbimet publike vendore




Tregues Performance	Trendi në parashikim
TP 1. Efiçienca buxhetore e shërbimeve publike vendore	=
TP 2. Përmirësimi i shërbimeve vendore	↗
TP 3. Përmirësimi i hapësirave të gjelbërta	=

# ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA

**TRASHËGIMIA KULTURORE,  
EVENTET ARTISTIKE DHE  
KULTURORE**





## TRASHËGIMIA KULTURORE, EVENTET ARTISTIKE DHE KULTURORE

Shpenzime	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan2022
Shpenzime Korente	7,259	6,435	7,300	6,680	7,052	7,283
Shpenzime Kapitale	-	-	960	-	-	-
<b>Total Shpenzime</b>	<b>7,259</b>	<b>6,435</b>	<b>8,260</b>	<b>6,680</b>	<b>7,052</b>	<b>7,283</b>

Zë rreth **2.3%** të buxhetit të bashkisë. Gjatë tre viteve të ardhshme bashkia synon ta përmirësojë punën e saj.

Oëllimi i programit buxhetor	Objektivi 2020-2022
Bashkia zbaton politika të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe organizimin e eventeve artistike dhe kulturore	Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe promovimi i eventeve kulturore dhe artistike

Suksesin e përdorimit të parave publike në këtë program bashkia e mat me anë të treguesve të performancës të cilët synojnë përmirësim në tre vitet e ardhshme.

### Treguesit e Performancës Buxhetore

Matja e Treguesve të Performancës Buxhetore	Fakt	Synimet			
	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i shfaqjeve kulturore; artistike të mbështetura me fondet e bashkisë – (ndryshimi vjetor në %)	Ni	26%	0%	0%	0%
Numri i aseteve të trashëgimisë kulturore nën administrimin e bashkisë (ndryshimi vjetor në %)	Ni	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%


Struktura e cila menaxhon këtë program buxhetor ka 5 punonjës me kohë të plotë pune, si pjesë e Qendrës së Artit dhe Kulturës i cili parashikohet të mbetet i pandryshuar në tre vitet e ardhshme.

Ky program buxhetor mbështet aktivitetin e përditshëm të personelit të administratës së bashkisë si:

Suksesin e përdorimit të parave publike në këtë program bashkia e mat me anë të treguesve të performancës të cilët synojnë përmirësim në tre vitet e ardhshme.

- **Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrim i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve**
- **Mbështetja e vendeve historike, kopshteve zoologjike dhe botanike**
- **Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i bibliotekave, e i ambienteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm qytetar**
- **Mbështetje për muzeumet, galeritë e arteve, teatrot, sallat e ekspozitave**
- **Organizim ose mbështetje për ngjarjet kulturore (koncerte, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike etj.)**
- **Sigurim i shërbimeve kulturore; administrim i çështjeve kulturore; mbikëqyrje dhe rregullim i strukturave kulturore**
- **Organizim i aktiviteteve kulturore dhe promovim i identitetit kombëtar e lokal.**

### Performanca e jetës kulturore



# ARSIMI


**ARSIMI PARASHKOLLOR  
PËRFSHIRË ARSIMIN BAZË**



**ARSIMI I MESËM I  
PËRGJITHSHËM**



9.7%



## ARSIMI PARASHKOLLOR PËRFSHIRË ARSIMIN BAZË

Shpenzime	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan2022
Shpenzime Korente	33,043	24,854	30,633	25,050	25,200	25,300
Shpenzime Kapitale	-	99	3,780	-	-	-
<b>Total Shpenzime</b>	<b>33,043</b>	<b>24,953</b>	<b>34,413</b>	<b>25,050</b>	<b>25,200</b>	<b>25,300</b>

Zë rreth **9.7%** të buxhetit të bashkisë. Gjatë tre viteve të ardhshme bashkia synon ta përmirësojë punën e saj.

Oëllimi i programit buxhetor	Objektivi 2020-2022
Ofrimi i arsimit bazë dhe atij parashkollor për të rritur përqindjen e popullatës që dinë shkrim dhe këndim	Bashkia ofron kushte për përmirësimin e arsimit bazë (9 vjeçar) dhe parashkollor

Suksesin e përdorimit të parave publike në këtë program bashkia e mat me anë të treguesve të performancës të cilët synojnë përmirësim në tre vitet e ardhshme.

### Treguesit e Performancës Buxhetore

Matja e Treguesve të Performancës Buxhetore	Fakt	Synimet			
	2018	2019	2020	2021	2022
- Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor – raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02
- Numri mesatar i nxënësve në një klasë – raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë	65	56	50	50	50


Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetese të Arsimit dhe Çerdhes e menaxhon këtë program buxhetor dhe ka 36 punonjës me kohë të plotë pune i cili parashikohet të mbetet i pandryshuar në tre vitet e ardhshme.

Ky program buxhetor mbështet aktivitetin e përditshëm të personelit të administratës së bashkisë si:

- Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës
- Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve
- Programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve
- Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore


Përgjatë tre viteve bashkia nuk parashikon investimenë këtë program

### Arsimi bazë parashkollor



	Tregues Performance	Trendi në parashikim
TP 1.	Përmirësimi i cilësisë së shërbimit parashkollor	=
TP 2.	Përmirësimi i cilësisë së shërbimit arsimor bazë	=





## ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM

Shpenzime	Fakt 2017	Fakt 2018	Plan 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan2022
Shpenzime Korente	3,042	2,643	11,485	2,471	2,532	2,544
Shpenzime Kapitale	4,630	-	-	-	-	-
<b>Total Shpenzime</b>	<b>7,673</b>	<b>2,643</b>	<b>2,699</b>	<b>2,471</b>	<b>2,532</b>	<b>2,544</b>

Zë rreth **0.8%** të buxhetit të bashkisë. Gjatë tre viteve të ardhshme bashkia synon ta përmirësojë punën e saj.

Qëllimi i programit buxhetor	Objektivi 2020-2022
Ofrimi i arsimit të përgjithshëm për të gjithë popullatën	Bashkia ofron kushte për përmirësimin e arsimit të përgjithshëm (mesëm)

Suksesi e përdorimit të parave publike në këtë program bashkia e mat me anë të treguesve të performancës të cilët synojnë përmirësim në tre vitet e ardhshme.

### Treguesit e Performancës Buxhetore

Matja e Treguesve të Performancës Buxhetore	Fakt	Synimet			
	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i nxënësve të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm publik kundrejt numrit total të nxënësve që përfundojnë arsimin bazë (9 vjeçar)	52%	45%	43%	43%	43%
Numri mesatar i nxënësve në klasë – Raporti numri total i nxënësve në arsimin e mesëm kundrejt numrit total të klasave në arsimin e mesëm publik	25	26	26	26	26


Struktura e cila menaxhon këtë program buxhetor ka 2 punonjës si pjesë e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, me kohë të plotë pune i cili parashikohet të mbetet i pandryshuar në tre vitet e ardhshme.

Ky program buxhetor mbështet aktivitetin e përditshëm të personelit të administratës së bashkisë:

- **Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore**
  - **Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale**
  - **Shpenzimet për paga për stafin mbështetës**
- **Administrim, inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave**
  - **Mbështetje për trajnimin e mëtejshëm të mësuesve**
  - **Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve të arsimit profesional (vetëm konviktet).**

Përgjatë tre viteve bashkia nuk parashikon buxhet për investime në arsimin parauniversitar të përgjithshëm.

### Arsimi i përgjithshëm



#### Tregues Performance

#### Trendi në parashikim

<b>TP 1.</b>	Rritja e frekuentimit të arsimit të mesëm	↗
<b>TP 2.</b>	Përmirësim standardit të shërbimit	=

